

VENDIM
Nr. 30, datë 27.3.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ARÇOVA”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, nenit 38, pika 1, germa “a”, dhe nenit 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a” dhe 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 242/5 prot., datë 29.2.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Arçova’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 242 prot., datë 25.1.2024, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Arçova”, me kapacitet prodhues 1280 kw, në Përroin e Arçorvës, degë e përroit të Seltës dhe Holtës, me derdhje në lumin Shkumbin, Bashkia Elbasan, qarku Elbasan.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 15, datë 6.2.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.2.2024 dhe 8.2.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.2.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 242/3 prot., datë 12.2.2024, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht; dhe

- me shkresën me nr. 242/4 prot., datë 19.2.2024, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin e kërkuar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Subjekti disponon leje të vlefshme të përdorimit të burimit ujor, e cila mban datën 22.11.2023 dhe është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare (deri më 22.11.2028). Ashtu si dhe në rastet analoge do t’i lihet detyrë shoqërisë të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor brenda datës 22.11.2028 dhe në rast se subjekti nuk e depoziton këtë leje brenda afatit të mësipërm dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Arçova”, me kapacitet të instaluar 1280 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Arçova”, brenda datës 21.11.2028.

3. Në rast se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. nuk depoziton në afat lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor, sikurse përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi